

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – Shërbime
NATYRE INTELEKTUALE

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*“Mbështetje me ekspertizë ligjore, financiare, teknike dhe mjedisore për projektin e investimit
“Pashaliman Laguna Eko Resort”*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
792 12400-7**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit: 27,000,000 (njëzet e shtatë milion) lekë pa tvsh ose 278,489 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 15/09/2025 është 96.91 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Korporata e Investimeve Shqiptare sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Bazuar në Nenin 42, pika 1 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021(i ndryshuar) *“Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve”*. Në rastin konkret, teknikisht është e pamundur të ndahet në lote. Nëse objekti do ndahej në lote, do të bëhej pothuajse i pamundur për shkak se është i njëjti aks, për më tepër në Termat e Referencës është i gjithë përshkrimi.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pike 2 /c të nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “Shërbim - Mbi kufirin e lartë monetar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenit 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

Nga AK është përcaktuar “jo më e vogël se 39 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet” me argumentimin për të pasur me shumë konkurrence dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim intelektual”. Kjo është mbështetur dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në *mbeshtetje të nenin 43, pika 1* ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, dhe kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të deshmojë kryerjen e shërbimeve të mëparshme të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do të vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur vërtetim për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate dhe/ose faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do të vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kriteri është miratuar me qëllim vërtetimin për eksperiencat e ngjashme të operatorit/ëve në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të kontratës.. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41, pika 3 të VKM-se vlerësohet se vlera e kërkuar në masën 39 % e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve.

2.3.2 Cv e operatorit ekonomik - një përshkrim i përgjithshëm i profilit të veprimtarisë, të dhëna të përgjithshme lidhur me eksperiencat dhe bashkëpunime në përmbushje të projekteve të ndryshme me natyrë shërbimi në fushën objekt prokurimi (Profili i kompanisë kërket, i prezantuar edhe nga prospekti i tij zyrtar (faqe interneti, katalog, etj.).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën.

2.3.3 Përvoja profesionale e ofertuesit. Ofertuesi duhet të paraqesë numrin e projekteve të investimit të suksesshëm për të cilat ku ofertuesi ka ofruar shërbime ekspertize të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit për projekte investimi minimumi 5,000,000 Euro (vlera minimale e kërkuar për investitorët apo projektet që përfitojnë statusin referuar ligjit nr. 55/2015 Për investimet strategjike në republikën e Shqipërisë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon staf të aftë për kryerjen e shërbimeve objekt të kësaj kontrate, për minimumi 5 (pese) eksperte, që të plotësojnë kriteret profesionale, akademike dhe të eksperiencës në fushën përkatëse si vijon:

1. Lideri i ekipit/Ekspert Ligjor

- a. Te jete i diplomuar në shkencat juridike
- b. Te kete kryer studime pasuniversitare ne shkencat juridike
- c. Të kete minimumi 20 (njëzet) vjet përvojë pune ne ofrimin e ekspertizës në fushen kontraktuale, rregullatore, koncesionare, infrastrukturore
- d. Të zotërojnë në nivel të lartë profesional të gjuhës angleze

2. 1 (një) Ekspert ligjor

- a. Te jene diplomuar në shkencat juridike
- b. Te kete kryer studime pasuniversitare ne shkencat juridike
- c. Të kete minimumi 20 (njëzet) vjet përvojë pune ne ofrimin e ekspertizës në fushen kontraktuale, rregullatore, koncesionare, infrastrukturore
- d. Të zotërojnë në nivel të lartë profesional të gjuhës angleze

3. 1 (një) Analist financiar/biznesi

- a. Te jete diplomuar në shkencat ekonomike/financiare apo ekuivalente
- b. Te kete kryer studime pasuniversitare në shkencat ekonomike/financiare apo ekuivalente
- c. Të kete minimumi 20 (njëzet) vjet përvojë pune në ofrimin e ekspertizës së ngjashme me ekspertizën e kërkuar në këtë procedurë prokurimi
- d. Të zotërojnë në nivel të lartë profesional të gjuhës angleze

4. 1 (nje) Ekspert ne fushen e mjedisit

- a. Te jete i diplomuar në fushen e inxhinierise se mjedisit ose ekuivalente
- b. Të zotërojnë Certifikaten “Vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin Mjedisor”
- c. Të kete minimumi 20 vjet përvojë pune ne fushen e mjedisit. Përbën avantazh eksperiencia ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen.

5. 1 (nje) Ekspert ne vleresimin e pasurive te paluajtshme

- a. Te zotëroje license individuale ne vleresimin e pasurive të paluajtshme (shkalla e parë) sipas VKM nr 712 datë 12.10.2016 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme" te cilat duhet të jetë në fuqi, te vlefshme, në ditën e hapjes së procedurës.
- b. Të kete minimumi 7 vjet përvojë pune si ekspert i licensuar ne vleresimin e pasurive te paluajteshme.
- c. Eksperienca ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen, perben avantazh.
- d. Të zotërojnë gjuhën angleze.

6. 1 (nje) Ekspert ne fushen e arkeologjise

- a. Te jete i licensuar per veprimtari arkeologjike nga Ministria e Kultures, Rinise dhe Sportit. Licensa duhet të jetë në fuqi, te vlefshme, në ditën e hapjes së procedurës.
- e. Të kete minimumi 10 vjet përvojë pune si ne fushen e arkeologjise.
- f. Eksperienca ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen, perben avantazh.
- g. Të zotërojnë gjuhën angleze.

7. 1 (nje) Ekspert ne fushen e restaurimit

- a. Te jete i licensuar ne projektim per veprimtari nderhyrese ne pasurite kulturore materiale: P/A/1, P/A/2/ P/A3/ dhe P/A/4 nga Ministria e Kultures, Rinise dhe Sportit. Licensa duhet te jetë në fuqi, te vlefshme, në ditën e hapjes së procedurës.
- b. Të kete minimumi 10 vjet përvojë pune si ne fushen e arkeologjise.
- c. Eksperienca ne projekte te ngjashme me shërbimet që këkohen, perben avantazh.
- d. Të zotërojnë gjuhën angleze.

Shenim: Për efekt të vlerësimit me pike sipas pikes 4.4 ne Njoftimin e Kontrates, operatorët të ngarkojnë dokumentacionin: *Diplomë, Librezë pune, CV, si dhe deshmi kualifikimi/ specializimi, licensa/certificata profesionale/ leter referenca ose **cdo lloj dokumenti tjetër ekuivalent që vërteton përmshjen e kritereve të kërkuara si me sipër.***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10.. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, Njesia e prokurimit per vendosjen e stafit i eshte referuar detyrave dhe objektiva të përshkruara te Termat e Referencës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta eksperte i referohet objektit te kontrates, konkretisht termave te references, pjese e DST. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Për plotësimin e kriterit të “Përqasjes teknike dhe metodologjisë” Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë ku të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesi problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e kësaj metodologjie me përqasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Bazuar në VKM-në Nr. 498, datë 1.8.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë: “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë jo më pak se 20 pikë dhe propozimi teknik jo më pak se 80 pikë. Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 dhe më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse.

II. Argumentimi i termave të references:

Specifikimet teknike Sipas Termave të Referencës, të përcaktuara bashkëngjitur DT janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdher të titullarit të AK.

Njesia e Prokurimit